

REKOMANDIME

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit)

Sesioni 3: Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale dhe përdorimi i pesticideve (Projekti pilot “Oazi Ekologjik i Butrintit”)

- Politikat bujqësore që synojnë transformimin e bujqësisë nga ajo konvencionale në atë të integruar dhe organike duke zbatuar parimet e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së natyrës dhe diversitetit gjenetik në bujqësi duhet të ndiqen dhe zbatohen. Në këtë mënyrë, rreziku që sjell përdorimi i produkteve mbrojtëse të bimëve (PMB-ve) mund të ulet ndjeshëm.
- Duhet investuar më shumë në rritjen e kontrolleve për të minimizuar shitjen e pesticideve në rrugë të jashtëligjshme dhe detyrimin për t'u pajisur me certifikatë dhe trajnime për stafin e bizneseve që shesin PMB.
- Rekomandohet që të përmirësohen sistemet e vendosura për të siguruar grumbullimin dhe analizën e plotë të të dhënave të shitjeve dhe përdorimit të PMB-ve, duke përfshirë informacionin mbi zbatimin e praktikave të menaxhimit të integruar të dëmtuesve në bujqësi në nivel ferme.
- Nevjitet të realizohen studime të gjendjes së pesticideve në zonat me prodhim të lartë bujqësor për të marrë masat për reduktimin dhe eliminimin në zonat që mund të rezultojnë me nivele të larta ose tej normave të lejuara.
- Është e nevojshme që strukturat shtetërore t'i japin prioritet financiar këtij sektori për rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit organik pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetesën e konsumatorëve.
- Nismat e ngjashme me “Oazin Ekologjik të Butrintit” të cilat ndihmojnë në zhvillimin e turizmit rural, agroturizmit, akuaturizmit, agropylltarisë duhet mbështeten pasi ndihmojnë në gjenerimin e të ardhurave në vend.
- Përdorimi i pesticideve kimike, veçanërisht kur bëhet fjalë për pesticide që përmbajnë substanca aktive më të rrezikshme duhet të reduktohet në të gjitha format e mundshme. Por, duhet të ketë një rritje në shkallën e përdorimit të alternativave më pak të rrezikshme dhe jo kimike.

- Duhet të përmirësohet disponueshmëria e të dhënave monitoruese për aplikimin dhe përdorimin e pesticideve si dhe përdorimi i teknologjive të reja në përpjekje për të rregulluar përdorimin e pesticideve.